

## Raport Muaji Dhjetor 2017

### Informacion bazë

Menaxhimi i Fondit	<b>Raiffeisen INVEST</b>
Monedha	<b>Euro</b>
Datë Lancimi	<b>22 Nentor 2012</b>
Vlera fillestare e kuotës	<b>100</b>
Shuma fillestare minimale	<b>250</b>
Shuma minimale pasuese	<b>50</b>
Komision në hyrje	<b>0%</b>
Komision në dalje	<b>0%</b>
Komision Administrimi në vit	<b>1.50%</b>
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	<b>Referojuni informacionit ne deget e RBAL</b>

### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në perputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.


Nje pjese e rendesishme e aseteteve te fondit mund te investohen ne bono dhe obligacione thesari te Qeverise se Republikës se Shqiperise, te emetuara ne monedhen euro. Megjithate, frekuenca e emetimeve ne euro nga Qeveria e Republikës se Shqiperise do te percaktoje shkallen ne te cilen Fondi do te investoje ne keto lloj instrumentash.

Fondi eshte i pershtatshem per individë dhe subjekte juridike te cilet mendojne se objektivi i investimit i Fondit perputhet me kerkesat dhe pritshmerite e tyre.

### Profili i Riskut të investitorit

Risk i ulët  
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë  
Përfitimet tipike më të larta




Fondi është në kategorinë e dytë të Profilit të Riskut

## Të dhëna për Fondin në 31.12.2017

<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>110,668,985</b>
<b>Numri i investitoreve</b>	<b>4,381</b>
<b>Cmimi i Kuotes</b>	<b>116.9382</b>
<b>*Kthimi vjetor nga investimi (31.12.2016-31.12.2017)</b>	<b>2.72%</b>

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e Portofolit të investimeve në 31 Dhjetor 2017




Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur rrezikun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Perqindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politiken e investimit dhe kriteretë të specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.

Obligacionet të quajtura “dytesore” (ose me termin financiar subordinated) përbejnë afërsisht 5.48% të portofolit në fund të muajit Dhjetor.


Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit në datën 31 Dhjetor 2017, 43.93% e asetëve të fondit janë të investuara në obligacione qeveritare dhe 35.78% e tyre i përkasin emetimeve të Qeverisë Shqiptare. Për qindja e alokimit të asetëve në depozita afatshkurtra është në nivelin e 5.02% të asetëve të fondit, ndërsa përafërsisht 24.54% e asetëve të fondit janë investuar në Fonde investimi, të cilat gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve.

Strategjia e investimeve nuk ka pesuar ndryshime thelbesore ne krahasim me periudhat paraardhese. Vlera neto e asetave te fondit qendron relativisht e pandryshuar ne krahasim me fund-Shtatorin duke arritur nivelin e EUR 110.7 milione me 31 Dhjetor 2017.



## Ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Dhjetor 2017

I tere portofoli i investimeve u karakterizua nga nje luhatshmeri e lehte gjate muajit Dhjetor, me cmimin e kuotes qe u rrit ne gjysmen e pare te muajit, per t’u ulur lehte ne gjysmen e dyte, teksa performanca vazhdon te mbetet shume e kenaqshme. Ne vijim te vendimit te Rezerves Federale Amerikane per te rritur normen e interesit baze, reaguan edhe normat e obligacioneve europiane, te cilat u rriten duke vleresuar keshtu negativisht portofolin e investimeve. Luhatshmeria erdhi edhe si rrjedhoje e pasigurise qe shoqeron ne pergjithesi diskutimet per daljen e Britanise nga BE dhe pasigurise mbi reformen fiskale ne SHBA, e cila ne vijim u finalizua me sukses.



Kthimi vjetor neto nga investimi ne fondin Raiffeisen Invest Euro vazhdon te jete shume i mire dhe konkurrues ne raport me alternativat e tjera te investimit ne tregun shqiptar. Kthimi net per periudhen 1-vjecare Dhjetor 2016- Dhjetor 2017 rezultoi 2.72%. Performanca e fondit eshte shume me e larte se norma mesatare e interesit e tregut per depoziten 1-vjecare ne monedhen Euro, e cila per te njejten periudhe qendronte ne nivelin e 0.16%.

Ne inkurajojme investitorët te kene nje horizont sa me te gjate investimi, ne menyre qe te perfitojne kthimin maksimal

nga investimi, dhe të mos rrezikojnë duke dalë nga fondit në momentin e gabuar. Portofoli i fondit Euro mund të ripozicionohet për të adresuar zhvillimet me të fundit të tregjeve financiare.

## Informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për Dhjetor 2017

Fokusi i tregjeve financiare gjatë muajit Dhjetor ishte mbi vendimmarrjen e bankave kryesore qendrore për normat bazë të interesit. Kështu, Banka Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit të 2017 për normat e interesit nuk ofroi të dhëna të reja, por rinenvizoi nivelin e lartë të dinamizmit ekonomik dhe sentimentin e mirë ekonomik.

Nderkohe, Rezerva Federale Amerikane (Fed) veproi sipas pritshmerive duke rritur normën bazë të interesit me 25 pike bazë, duke arritur në intervalin e 1.25% - 1.50%. Tregjet financiare presin tre rritje të metejshme të normave përgjatë 2018.

Nderkohe, për sa i përket situatës politike në Mbreterinë e Bashkuar dhe diskutimeve për Brexit, pas 6 muajsh negociatash, marrëveshja e shumëpritur e divorcit të Britanisë me BE shënoi një hap të madh përpara më 8 Dhjetor 2017. Britania arriti një marrëveshje historike për termat e daljes nga BE, duke ruajtur të drejtën të posaçme për 4 miliona shtetas dhe duke rënë dakort për të paguar një tarifë prej 40 deri në 60 bilione Euro për divorcin që po i cel rrugë bisedimeve mbi marrëdhëniet tregtare gjatë 2018. Kryeministria e Mbreterisë së Bashkuar dhe presidenti i Komisionit Europian nënshkruan një "progres-raport" që do të lejojë negociatorët e BE të rekomandojnë hapjen e fazës së dytë të bisedimeve mbi marrëdhëniet post-Brexit.

Në anën tjetër të Atlantikut, në vijim të votës në Senat dhe Dhomen e Perfaqësuesve, Presidenti Amerikan Donald Trump nënshkroi ligjin e reformës së re fiskale më 22 Dhjetor. Në thelb të reformës qëndron ulja e normës së taksës për korporatat nga 35% në 21%. Ligji i ri fiskal ka për synim të transformojë sistemin fiskal të SHBA dhe sipas Republikaneve, paketa që parashikon ulje taksash prej 1.5 trilionë \$ është jetesore për të rienergizuar ekonominë amerikane. Paqartësitë për reformën fiskale kishin sjellë rënien e bursave të aksioneve, por fillimisht nënshkrimi i reformës, letrat me vlerë ndërkombëtare dhe aksionet rikuperuan terrenin. Gjithashtu, ulja e taksave në SHBA do të nxiste rritjen ekonomike dhe inflacionin duke rritur kështu për rrjedhojë probabilitetin për rritje me agresive të normave të interesit.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm janë të ftuar të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit.

Raiffeisen Invest dhe bankierët e Raiffeisen Bank nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sh.a., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al), ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.